

Sektori i veprave civile, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 14.07.2021, miratoi:

MENDIM JURIDIK

Kërkesa me padi e punëtorit, për të kërkuar nga punëdhënësi të realizojë pagesën e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor në Fondin SPIMV, **NUK PARASHKRUHET.**

A r s y e t i m

Sipas nenit 4 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.98/201215/2013 – tekst i pastruar), të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor fitohen dhe realizohen varësisht nga mënyra, kohëzgjatja dhe vëllimi i depozitimit të mjeteve për sigurim pensional dhe invalidor në kushte të përcaktuara me këtë ligj. Në nenin 5 paragrafi 1 nga i njëjti ligj, janë të përcaktuara se cilat janë ato të drejta themelore nga pika 1 deri në pikën 6.

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor nuk mund të parashkruhen, përveç shumave të arritura, ndërsa të papaguara të pensioneve dhe të mjeteve tjera me para, në rastet e përcaktuara me Ligj sipas nenit 6 paragrafi 2 nga i njëjti ligj. Në nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, është përcaktuar me ligj se mjetet e nevojshme për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor i sigurojnë të siguarit dhe punëdhënësit nëpërmjet pagimit të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor në pajtim me Ligjin.

Sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për kontributet e sigurimit të obligueshëm ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 142 nga 10.11.2018), obligues për llogaritje dhe pagesë të kontributeve është punëdhënësi për të punësuarit e tij. Llojet e kontributeve, ndër të cilat janë edhe kontributet për sigurim pensional dhe invalidor janë të përcaktuara në nenin 5 paragrafi 1 nga pika 1 deri në pikën 5 nga i njëjti Ligj.

Sipas nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji i theksuar, kontrollin, përcaktimin, arkëtimin, arkëtimin e detyrueshëm, parashkrimin dhe shlyerjen e kontributeve e kryen Drejtoria për të hyra publike, në pajtim me Ligjin për procedurë tatimore.

Sipas nenit 122 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë tatimore ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 13/06.... nr.53/11), pagesa e tatimeve dhe të dhënat sekondare tatimore parashkruhen në afat prej 10 vjetësh nga skadimi i vitit në të cilin tatimi dhe të dhënat sekondare tatimore kanë arritur për pagesë.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të Ligjeve të theksuara, pa kontest buron se çështja e parashkrimit të kërkesës së punëtorit ndaj punëdhënësit, nëse për arsye të ndonjë shkakut punëdhënësi si obligues për llogaritje dhe pagesë të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor nuk ka vepruar sipas nenit 13 paragrafi 1 dhe pika 1 të Ligjit për kontributet e sigurimit të obligueshëm social, si dhe atë nëse Drejtoria për të hyra publike nuk ka vepruar sipas nenit 23 paragrafi 1 nga i njëjti Ligj nuk është rregulluar.

Me ligjet e theksuara është rregulluar vetëm çështja e parashkrimit për pagesën e tatimeve dhe të dhënat sekondare tatimore.

Nga e ekspozuara, ndërsa duke u udhëhequr nga fakti se pagesa e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor paraqet bazë dhe kusht për realizimin e atyre të drejtave në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ndërsa ato të drejta nuk parashkruhen sipas nenit 6 paragrafi 2 nga i njëjti Ligj, nuk parashkruhet edhe e drejta që me padi punëtori të kërkojë pagesën e kontributeve të papaguara nga punëdhënësi.

Kjo për arsye se, punëtori me padi për pagesë të kontributeve të papaguara nga ana e punëdhënësit e realizon të drejtën që i takon sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ndërsa nuk ka të bëjë me kërkesë monetare.

Nga e theksuara, Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstaton se në procedurën e realizimit të së drejtës për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor nuk ka bazë për zbatimin e dispozitave të Ligjit për marrëdhënie obliguese, të cilat kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës për kompensim të dëmit, por as edhe dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore, të cilat e rregullojnë çështjen e parashkrimit të tatimeve dhe të dhënat sekondare tatimore.

Nga e ekspozuara, Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi dhe e përcaktoi këtë mendim juridik.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**